



P R O C E S V E R B A L I

Mbledhja e këshillit komunal për siguri në bashkësi (KKSBB) në Rahovec, e mbajtur më 29.08.2022 me fillim në ora 15:30. Mbledhjen e kryesoi kryetari komunës **Smajl Latifi**: Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi.
Kryetari- Më lejoni t'i përshëndes të gjithë anëtarët e KKSBB, përshëndes nënkyetarin e komunës, Fatmir Iska, drejtori e drejtive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovacit z.Fazli Morina, përfaqësuesit e bashkësive fetare, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjerë që janë prezent në sallë. Është mbledhja e pestë e rregullt e këshillit komunal për siguri në bashkësi. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

Rend Dite

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Informatë rreth situatës së krijuar nga pandemia covid19;**
- 3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovcit;**

-Prishja e qetësisë publike nga lokalet e natës dhe nga personat e papërgjegjshëm.

-Trajtimi i mbrojtjes së pyjeve nga dëmtuesit ilegal.

-Vetëdijesimi nga minat dhe mjetet tjera të pashpërthyera nga lufta.

-Identifikimi i hapësirave për çasjen e personave me nevoja të veçanta.

-Siguria në trafik.

-Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje.

-Veprimi dhe masat për luftimin e shkelësve të ligjit në komunën tonë.

- 4. Informatë rreth përgatitjes të festës së vjeljes së rrushit – HARDH FEST;**

- 5. Të ndryshme;**

Kryesuesi – A jeni të pajtimit me këtë rend dite?... Kush është për?... Votë kundër?... Abstenime?... Konstatojmë që është miratuar rendi i ditës për këtë takim, i datës 29 gusht 2022.

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;** Nëse nuk ka askush ndonjë vërejtje apo sugjerim rreth procesverbalit, kush është “për” miratim?... Faleminderit.
- 2. Informatë rreth situatës së krijuar nga pandemia covid19;** Fillimisht ju përshëndes të gjithëve, këtu kemi shumë prej tyre që mund të na ndihmojnë, komandanti i stacionit të policisë z. Fazli Morina, kemi

prezent edhe anëtarët e FSK-së, OSBE-së, shoqëri civile. Faleminderit. Shkurt rrëth situatës me covid, numrin e të vaksinuarve janar-qershori 2022, numrin e rasteve me covid ...

Saranda Sallteku – Faleminderit kryetar, përshëndetje për të gjithë. Sa i përket situatës rrëth pandemisë covid – 19, situaçia është e qetë dhe e menaxhueshme, deri më tani në komunën tonë kemi 29 raste aktive përmomentin, gjithashtu gjatë 5 ditëve të javës bëhet testimi në QKMF, në QMF në Ratkoc dhe në QMF në Krushe të Madhe. Gjatë muajit gusht 2022 kemi patur një fluks më të madh të infektuarve me covid me një mesatare 50 pacientë në ditë të testuar dhe prej tyre gjysma pozitivë. Vaksinimi punon me orar prej orës 8:00 deri në ora 16:00, 5 ditë në javë. Gjatë periudhës nga janari e deri më tani, me dozë të parë i kemi të vaksinuar 599 persona, me dozën e dytë 1065 persona, me dozë të tretë gjithsej kemi 2970 persona, për shkak se doza e tretë ka qenë prej shtatorit aktuale prej shtatorit 2021.

Kryesuesi - Kemi vërejtur një rritje të të infektuarve kohët e fundit, por efektet e virusit nuk janë ato siç kanë qenë më herët, aktualisht kemi 29 raste aktive dhe shpresojmë që secili prej tyre t'a ketë trajtimin e duhur dhe të shërohet sa më shpejtë. Ne nuk e shohim si problem serioz tanë pandeminë për shkak sigurisht që vaksinimi ka mundësuar që të kemi një organizëm më të përgatitur dhe t'a luftojmë virusin korona.

3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit;

Gjendja e sigurisë në komunën tonë ka qenë stabile dhe mbetet stabile, ka patur një fluks të madh të bashkatdhatarëve tanë edhe në komunën tonë gjithashtu aktivitetë të shumta të organizuara nga DKRS në bashkëpunim me bizneset. Gjatë kësaj kohe ka patur aktivitetë në rritje edhe sa i takon realizimit të të ardhurave komunale në komunë. Qetësia publike; edhe policia ka bërë përpjekje t'a kryen detyrën e vet, lokalet e natës poashtu siç e dini që deri në ora 23:00 kanë të drejtë të ushtrojnë veprimtarinë, pas kësaj ore e kanë të ndaluar sepse është konsideruar që më shumë ka probleme sesa të mira, më shumë pasoja sesa dobi dhe komuna e Rahovecit ka vlerësuar që këto lokale duhet t'a ndërprenë veprimtarinë e tyre pas orës 23:00. Motoçikletat janë akoma prezente, sidomos në qytet, normalisht që bëjnë shumë zhurmë dhe kemi vazhdimisht ankesa. Mbrojtja e pyjeve nga dëmtuesit ilegal, ne kemi një rekomandim prej agjencisë së pyjeve dhe ministrisë të jemi më të vëmendshëm për angazhim për mbrojtjen e pyjeve nga keqpërdoruesit.

Te mjetet e pashpërthyera; kemi hasur te një qytetar në Fortesë, në mes Fortesës dhe Celinës është gjetur një mjet i pashpërthyer dhe sigurisht i luftës së fundit me gjasë.

Te shënjimi i vendeve për njerëz me nevoja të veçanta, kemi bërë një punë të mirë këtu, por ne e lusim policinë por edhe anëtarët e KKSBB-së këtu, kudo që vlerësoni që mund të shënjojen zona të ndryshme për persona të veçanta, ne jemi të gatshëm të lidhim kontratë, ia dërgojmë drejtorisë së shërbimeve publike. Te dhuna në familje; si administratë edhe ne po e kuptojmë që numri i dhunës në familjes është në rritje. Te zjarret; ka patur aktivitetë kundër zjarreve nga zjarrfikësit tanë, por sigurisht ju ftojmë të raportoni në institucionë kompetente nëse shihni ndonjë ndezje.

Fazli Morina – Faleminderit kryetar, përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë. Sa i përket situatës së sigurisë, është e qetë dhe stabile në realitet prej momentit të raportimit të herës së fundit e deri më tani. Gjatë kësaj periudhe kemi 74 raste të veprave penale, 2 incidente jopenale. Nga këto raste mund të veçojmë 9 raste vjedhje, 11 vjedhje të rënda, 5 raste dhunë në familje, armëmbajtje pa leje 5 raste, të konfiskuara 6 armë, në 4 raste janë ahengje dhe dasma, të konfiskuara 4 armë me municion të ndryshëm. Një rast që ka ndodhur ditë më parë, ia vlen t'a përmendim. Me datë 26.08.2022 në ora 10:00, nga një dëshmitar është raportuar në stacion policor në Rahovec se në varrezat ortodokse të cilat gjenden në rrugën "Mizair Isma" në Rahovec në kodër, në periudhën prej datës 07.08-25.08 është dëmtuar kryqi prej druri në një varr nga persona të panjohur, patrullat policore si dhe njesitë e hetimeve kanë bërë shikim e vendit të ngjarjes, janë intervistuar dëshmitarët. Varri i të dëmtuarit i përket bashkëshortit N. Iliç i cili është varrosur me datë 01.08.2022 deri më 07.08.2022 kanë deklaruar se varri ishte në gjendje të rregullt pasi vizitohej çdo ditë.

Lidhur me rastin është njoftuar edhe prokurori i shtetit i cili ka udhëzuar të veprohet dhe të emërohet si dëmtim i varreve dhe kufomave. Rasti është duke u hetuar nga stacioni policor në Rahovec, gjithashtu në bashkëpunim me drejtorinë rajonale të policisë në Gjakovë. Siguria në komunikacionin rrugorë vazhdon të jetë e njejtë, nuk është aq e mirë, por mund t'a quajmë të mirë duke marrur parasysh që jemi në zbatim të planit operativ të sezonës verore, gjatë kësaj kohe 1286 janë gjoba të trafikut, 233 prej tyre për parkingje të palejuar, 13 kundervajtje për prishje të rendit dhe qetësisë publike. Për fat të mirë te siguria në shkolla, kemi 1 rast si dëmtim apo asgjësim i pronës me datë 23.08 në ora 19:00 ankuesi ose drejtori i shkollës filllore "Haki Stërmilli" në fshatin Retijë ka raportuar në stacionin policor në Rahovec, se persona të panjohur kanë demoluar 4 ulëse, 2 rrjeta të golave të fushës së sportit, 2 kosha të basketballit dhe 2 shporta për hedhjen e mbeturinave. Nga stacioni policor janë dërguar njesitë në vend të ngjarjes, kemi marrur të gjitha veprimet, janë marrë disa intervista, rasti është i zbuluar dhe vazhdon në procedurë të rregullt. Kërkesa jonë është te vendosja e kamerave, konkretisht në fshatin Hoçë e Madhe dhe në varrezat e përmendura më lartë. Pak ditë më parë kemi pas edhe në Hoçë të Madhe ku janë thyer dy shitore-lokale ushqimore dhe nuk e di unë pse është kërkuar të marrim pëlqim prej fshatarëve atje për vendosjen e kamerave, për asnjë vend tjetër nuk është kërkuar ky lloj pëlqimi, nuk e di pse të marrim pëlqim kur kjo është për interesat shoqërore. I qëndrojmë mbrapa kësaj kërkesa për vendosjen e kamerave të sigurisë në këtë dy zona, është ndihmë e madhe për neve që sa më shpejtë fajtorët të dërgohen para drejtësisë.

Lulzim Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë, dëshiroj t'a parashtoj një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike në lidhje me rrugën e UÇK-së, meqenëse jemi para sezonës së vjeshtës, kushtet atmosferike si shira të shumta dhe realisht n'a pamundësohet krycja te rruga e UÇK-së. Bëhet fjalë për zgjerimin e rrugës e paraparë me projekt. Faleminderit.

Shaip Shala – Përshëndetje kryetar, pjestarë të FSK-së dhe të gjithë të pranishmit. Jo vetëm unë që kam një hall, por të gjithë banorët e lagjes ku edhe rrjimë në mbrëmje ne të moshuarit, nuk kam qejf t'a përmendi fjalën "pleqë". M'u në segmentin rrugor të rrugës kryesore nga fillon rruga "Sadedin Hajda" është në pyetje zhurma e motorrave që zakonisht dëgjohet edhe në dhomën time, tejkalimi i shpejtësisë gjithashtu, sepse segmenti rrugor nuk është aq i gjatë, deri te pengesa para shkollës "Sadedin Hajda". Pyetje është; a mund të shqyrtohet mundësia që të vendoset edhe një pengesë rrugore aty?... Fatmirësish nuk ka ndodhur deri më tani asgjë, asnjë fatkeqësi, por si parandalim, e domosdoshme do të ishte edhe një pengesë para pompës "Petrol Company". Tjetër; në Rahovec e kemi një lëmoshkërkuese, që ka probleme mendore dhe është mjaftë e rrezikshme. Ka raste kur njeriut i kërkon para me forcë (zor). Një rast; Pas varrimit të të ndjerit Xhevdet Bajraj, te semaforat rastis një njeri mysafir i cili nuk e njeh fare, ia dha 1.5 Euro, kjo e pakënaqur ia kërkon 5 Euro në mënyrë arrogante. Në këtë rast doja të ndërhyja si një polic në komunitet, por të them të drejtën pata frikë. Ka edhe shumë raste tjera që nuk janë aspakt mirë t'i them këtu sepse janë të pahijshme, këtu duhet të ketë punë qendra për punë sociale sepse edhe policia nuk ka çka t'i bëj. Faleminderit.

Egzon Hamza – Përshëndetje për të gjithë, jam Egzon Hamza përfaqësues i komunitetit Egjiptian. I nderuar z.kryetar, po ju drejtohem juve personalisht në këtë takim tejet të rëndësishëm që ka të bëjë me sigurinë e qytetarëve. Para disa dite kam kontaktuar edhe me drejtorin z. Krasniqi, gjithashtu kam informuar edhe z. Qelin me problemin që kemi lidhur me kapakun e kanalizimit, që një javë në lagjen tone është dëmtuar kapaku kryesor i kanalizimit që ka një thellësi prej 2metra, ku paraqet një rrezik për kalimtarët e posaçërisht për fëmijët që priten t'ia fillojnë mësimin këtë javë. Si përfaqësues i këshilit të sigurisë e kam për obligim të ju informoj juve si i pari i komunës dhe ju lus që kërkeshën time t'a merrni me seriozitet, pasiqë në këtë kanalizim nuk është kapaku fare, rrezikshmëria për kalimtarët është e madhe posaçërisht në mbrëmje.

Millan Stojanovic – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, e falënderoj z.Morinën për raportin të cilin e dha dhe që i përmendi rastet sa i përket Hoçës së Madhe dhe lagjes së epërmë – varrezat ortodokse. Biljana,

zonja që është nga Hoça e Madhe që për momentin mungon ajo, ka patur kërkesë të cilën e ka dërguar te unë që ka të bëjë me çështjen e ndriçimit publik në fshatin Hoçë e Madhe dhe besoj që vjedhjet që kanë ndodhur mund të jeni shkas i mungesës së ndriçimit publik, besoj që lidhur me këtë do të kemi një përgjigje pozitive nga ana juaj.

Vjollca Gurgule – Përshëndetje kryetar, përshëndetje për të gjithë juve. Meqë jemi në prag të fillimit të vitit të ri shkollor, kërkoj edhe një herë prej komandantit të policisë edhe prej juve kryetar që të shton edhe një herë kujdesin dhe kontrollin rrëth parkingjeve që po ndodhin afër shkollave, mirëpo te hyrja në oborr të shkollës patjetër duhet e jetë e lirë për të hyrë fëmijët në shkollë. Nuk e di a ka mundësi të bëhet kjo që do të kërkoj, por së paku do t'a bëjë një kërkesë zyrtare që të lirohet obori i shkollave për parkingje të prindërve apo të arsmitarëve që vijnë gjatë orarit që e kanë mësimin. Tjetër gjë që lidhjet me kërkesën time të zakonshme, po e shfrytëzoj edhe një herë mundësinë për rishikimin e mundësisë së vendosjes së atyre konave sepse e kemi shumë me rendësi që fëmijët t'a kenë sigurinë e nevojshme. Paraprakisht faleminderit për të gjitha institucionet me të cilat në kontunuitet kemi bashkëpunuar fytshëm.

Fazli Morina – Sa i përket rasteve që po n'a ndodhin te komuniteti joshumicë, sidomos te rastet e komunitetit Serb, në Hoçë dhe në Lagjen e epërme. Mbi të gjitha rastet te varrezat kanë një ndikim tjetër, është tjetër veprë penale mbi të gjitha e ndejshme dhe e rendë pa marrë parasysh cilit komunitet i ndodhë. Sa i përket vjedhjes, vjedhja është vjedhje, nuk njeh as komb as gjini as ngjyrë, prandaj lidhur me këtë kërkoj të gjithë nga ju që në këtë drejtëm të kontribuojmë pak më shumë. Për zonjën Vjollca, rrëth parkingjeve; nuk e di a e dini, por është një portal i mirë “lajmëro Policinë” kemi marrë shumë informata deri tani, rrëth parkingjeve, vozitjes etj... mjafton një foto duke e dërguar te portali ynë me lokacion, gjoba i shkon edhe pastaj.

Kryesuesi – Për t'a forcuar sigurinë në komunën tonë duhet të angazhohemi me ekipet tona, në bashkëpunim me policinë dhe inspektoriatin duhet t'i lirojmë trotuaret nga automjetet, hapësirat publike që uzurpohen padrejtësisht nga tjerët sepse ka një rregulllore që është miratuar nga kuvendi i komunës. Ne kemi detyrim ligjor që t'a pastrojmë mjedisin aty ku jemi dhe mos t'a ndotim ambientin aty ku nuk jemi, duke e larguar prej shtëpisë mbeturinat në një vend tjetër joadekuat, në dri, në pusetë të kanalizimit etj... Roli i anëtarit të KKSBB-së besoj që është një mjaftë i çartë, duhet të bëni luftë në komunitet t'i sqaroni njërcëzve dhc raportoni situata të ndryshme. Mirëmbajtja e ndriçimit publik; kemi pak vështirësi sepse edhe çmimet janë rritur, i kemi disa drita të fikura në qytet, të dëmtuara nga qytetarët dhe pjesëmarrësit në trafik, ne jemi duke provuar t'a përfundojmë këtë punë duke e rritur sigurinë në publik të qytetarëve. Kemi raste që në fshatin Zoqisht, ndriçim publik nuk ka, gjithashtu hajni nuk ka, prandaj jo çdo herë duhet t'a lidhim punën e mungesës së ndriçimit disa vjedhje që potencialisht kanë mund të ndodhin sepse ato ndodhin edhe kur kemi ndriçim publik, si ashtu si kështu duhet të trajtohen si vepra të dënuara. Në Hoçë të Madhe nuk është arsyja e mungesës së ndriçimit publik, vjedhjet që kanë ndodhur sepse ka ndodh vjedhje edhe në xhami këtu në Rahovec edhe pse ndriçim publik ka patur në maksimum. Kamerat e sigurisë; sot për sot nuk kemi mundësi financiare, përndryshe unë besoj që nuk duhet të pyetet askush se a duhet të vendosen kamerat e sigurisë apo jo. Kamerat e sigurisë neve na duhen t'a mbrojmë jetën e qytetarëve, vjedhjeve dhe gjithçka që ka të bëjë me siguri, direkt apo indirekt. Në momentin e shqyrtimit të mundësisë financiare kamerat e sigurisë do të vendosen sa më shpejt që është e mundur. E lus komandantin e policisë, për rastin e varrezave ortodokse, nëse mund të ketë ndonjë çasje te kamerat private sepse ne jemi të interesuar mos të lejojmë hapësirë të keqpërdorimit, që më pas t'a lidh këtë gjë me raportet ndëretnike të cilat janë shumë në rregull. Nuk ka ndodhur ndonjëherë që dikush të demoloj pllakat e varrit, në traditën e popullit autokton nuk kemi patur kësi ndodhi edhe nëse ka ndodhur ndonjëherë është gjykuar mirë. Edhe vjelja e rrushit dhe pranimi i tij ndihmon në siguri, ju duket që po flas “palidhje”, por greva që po ndodh këtu nuk e cenon sigurinë por krijon kufizime në shërbime. Ne nuk iu kemi thënë as hyni në grevë as dilni nga ajo, sepse është e paraparë me kushtetutë dhe ligj. Reduktimet e energjisë elektrike; kuptohet që e dëmtojnë sigurinë tonë, mund të kenë probleme familjet tona, i prishet një televizor në mungesë të energjisë, nevoja për dru shtohet, rritet kostojta e jetesës, rriten çmimet etj... Uji i pijshëm; Jemi duke shkuar në stinën e vjeshtës dhe besoj që edhe ato

reduktime që kanë mundur të jenë si pasoj e ndërprerjes së energjisë elektrike mund të ketë stabilitet, sidomos te stacioni numër 1 që nuk duhet të ndalet asnjëherë rryma sepse në çoftëse ndalet këtu, atëherë qyteti mbetet pa ujë. Ne do të përpinqemi të bëjmë presion t'a ushtrojmë ndikimin tonë te K.R.U Gjakova, te KOSTI, KESKO dhe KEDSI në mënyrë që të kemi sa më pak telashe në këtë vend.

Shitësit ambulantë; Ne besoj që jemi të pajtimit që duhet të largohen nga pjesët qëndrore dhe kryesore të qytetit sepse mund të cenojnë pak a shumë sigurinë duke i zënë trotuaret, e me parkingje të ndryshme. Ne duhet t'i marrim masat tona pavarësisht që nuk na pëlqen t'i lëndojmë prodhuesit bujqësorë, por ne provojmë t'iu gjejmë edhe vendet ku munden të bëjnë plasmanin e produkteve të tyre. Hedhja e mbeturinave në vende joadekuate, ne e kemi dënuar një qytetar me gjobë 2000eu, për shkak se mbetjet shtazore i ka hedhur në dri. Nuk ka tolerime, kur ka kompani të ndryshme që mund të krijoj marrëdhënie kontraktuale me cilindo person fizik apo juridik si dhe me ekonomi familjare që për pak cent mbetjet shtazore i dërgon në deponi speciale në Zhur. Prandaj ju siguroj që inspektoriati jonë do të jetë shumë aktiv duke i ftuar edhe inspektorët e nivelit qëndror të republikës për kësi lloj aksionesh. Ne e kemi deponinë legale rrugës për Drenovc në të majtë, dy kompani që operojnë me mjaftë sukses për grumbullimin e mbeturinave, si dhe deponinë speciale për mbetje shtazore në Zhur dhe është jologjike të kemi tolerance për ndotësit e drinit të bardhë apo çfarëdo mjedisit tjetër me mbetje shtazore. Te rruga tranzite, zgjerimi i rrugës; jemi duke i pritur operatorët në fillim të shtatorit të kthehen në punishte, ka lajme që mund të kompenzohen rrith 20% të humbjeve të supozuara për shkak të rritjes së çmimeve për kontratat që janë lidhur para rritjes së çmimeve, shpresojmë që ky lajm t'i rikthejë kompanitë në punë. Eshtë e vërtetë që Vjollca e ka ngritur edhe një herë çështjen rrith konave te SHL Kosova dhe çështjen e parkingjeve. Nuk jam kundër që oborrat e shkollave të lirohen, por dikush duhet t'a menaxhoj aty situatën, shumë njerëz thonë; jam prind i atij nxënësi/e, nuk mund t'a verifikojmë a është prind apo jo si dhe nuk guxojmë që mjediset shkollorë t'i rikthejmë në mundësi për keqpërdorues, duket analizë më e thellë. Ndërsa për vendosjen e konave, Përparimi nuk është këtu por nuk kam qejf të përsëritet kjo çështje më te SHL Kosova, duhet të vendosen. Te kapakët e pusetave, ne e kemi autorizuar kompaninë "Etniku" që t'i vendosë kapakët në lagje të epërme dhe 2 të tjerë rrugës për Hamoc.

4. Informatë rrith përgatitjes të festës së vjeljes së rrushit – HARDH FEST;

Kryesuesi – Së pari unë i ftoj të gjithë qytetarët e Rahovecit të marrin pjesë me familje me miqë në një ngjarje të madhe kulturore, turistike të trashëgimisë – traditës.

Policia e Kosovës është duke e përgatitur një plan operativ që të shkoj gjithçka në rregull me datë 2,3,4 shtator sepse pritet të ketë shumë njerëz vendorë e ndërkombëtarë, ministra, deputetë, ambasadorë, diplomatë. Besoj që ne do t'i marrim të gjitha masat edhe si komunë që ngjarja të shkoj si është më së miri.

Fazli Morina – Sa i përket "Hardh Festit" në kuadër të stacionit policor i kemi marrur të gjitha veprimet, është përgatitur plani operativ, është i caktuar numri i personelit, ka mjaftë të angazhuar; njësia për reagim të shpejtë, personel me rroba civile etj... Pritet te jetë një numër i madh i njerëzve, nuk do të tolerohet vozitja nën ndikim të alkoolit do të veprohet sipas ligjit për të gjithë që kjo festë të kaloj në mënyrën më të mirë të mundshme.

Kryesuesi – Komandanti është duke thënë, që turistat mund të pijnë, por shoferi jo. Eshtë festival i rrushit, njerëzit nuk kanë nevojë të marrin drogë e armë me vete sepse institucioni nuk të pyet, dënimet janë të rënda.

Dëshira jonë nuk është të dënojmë, por ne duhet t'a mbajmë dinjitetin e ngjarjes prandaj nuk ka tolerime në këtë aktivitet ndërkombëtar. Kjo ngjarje ia sjell Rahovecit rrith 10.000.000 euro qarkullim për 3 ditë në këtë krizë, është ekonomi dhe mjedis mjaftë i mirë.

5. Të ndryshme;

Kryesuesi – Kjo mbledhje është e paraparë në shtator, por për shkak të "Hardh Festit" po e mbajmë, ndoshta edhe ky ka qenë mesazhi meqenëse jemi pranë një festë të madhe ndoshta është mirë që edhe ju si anëtarë të KKSB-së t'a rrithni seriozitetin në përkushtim të asaj që punët të na ecin sa më mirë.

Fazli Morina – Faleminderit kryetar që sado pak më ndihmove në sqarime dhe detaje, qëllimi i përmenda njësitë që janë të angazhuara nga jashtë, derisa i përmenda njësitë, kuptohet që aty ka antidrogë,

antikorupcion, krime ekonomike, civil etj.. kjo është e gjitha për parandalim të drogës, armëve, vjedhjes, prishjes të rendit dhe qetësisë publike dhe gjithçka që mund të ketë negative gjatë 3 netëve në festival.

Kryesuesi – Komandant faleminderit, unë ju falënderoj të gjithëve për angazhimin, ne do të takohemi diku në shtator – shpresoj që e vjela do të jetë e bereqetshme.

Sic e dini ne jemi në grevë dhe kjo po na vështirëson sado pak punët, ligji për pagat në sektorin publik duhet të miratohet sa më shpejtë, greva në njëren anë, situata me energji elektrike, dialogu për marrëveshje përfundimtare nuk janë situata të kollajshme, duhet tejkaluar... Në çoftëse vazhdon kështu me grevë do të bëhet shumë më vështirë njerëzit sepse janë duke u kthyer për mosshërbim për dokumente. Ju faleminderit, mirupafshim në takimet tjera...

Mbledhja përfundoj në ora 16:20

Procesmbajtësi

Albion Krasniqi



Kryefari i Komunës

Smaji Latifi